

KOMUNIKATË PËR UEB

Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), 2023

24.07.2024

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për vitin 2023.

Shkalla e papunësisë në Kosovë 10,9%

Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 171 763) janë popullsi në moshë pune (23 663 më pak se në vitin paraprak).

Persona aktivë ishin 477 350 (15 456 më pak se në vitin paraprak).

Persona joaktivë ishin 694 413 (39 119 më pak se në vitin paraprak).

Persona të punësuar ishin 425 499 (21 686 më shumë se në vitin paraprak).

Persona të papunësuar ishin 51 851 (6 230 më pak se në vitin paraprak).

Treguesit kryesorë të tregut të punës 2023 / 2022

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (NË MIJËRA)	2023			2022		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia punëtore (persona aktivë) (15-64 vjeç)	333 019	144 331	477 350	329 469	132 425	461 894
Persona joaktivë (15-64 vjeç)	243 270	451 143	694 413	264 056	469 476	733 532
Të punësuar (15-64 vjeç)	307 509	117 990	425 499	293 285	110 528	403 813
Të papunësuar (15-64 vjeç)	25 510	26 341	51 851	36 184	21 897	58 081
Të rinj të papunë (15-24 vjeç)	6 051	4 945	10 996	7 338	5 204	12 542
Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)	48 369	47 824	96 193	49 665	49 040	98 705
Punësimi i paqëndrueshëm (15-64 vjeç)	55 570	9 671	65 241	46 145	7 640	53 785
Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)						
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	57.8	24.2	40.7	55.5	22.0	38.6
Shkalla e joaktivitetit (15-64 vjeç)	42.2	75.8	59.3	44.5	78.0	61.4
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) (15-64 vjeç)	53.4	19.8	36.3	49.4	18.4	33.8
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	7.7	18.2	10.9	11.0	16.5	12.6
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	14.4	22.8	17.3	18.6	27.0	21.4
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	32.9	33.9	33.4	32.2	33.8	33.0
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	18.1	8.2	15.3	15.7	6.9	13.3

Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 57,8% (2,3% më e lartë sesa në vitin paraprak). Kurse, përqindja e femrave të punësuar ishte 24,2% (2,2% më e lartë sesa në vitin paraprak).

Shkalla e punësimit ishte 36,3 % (2,5% më e lartë sesa në vitin paraprak).

Shkalla e papunësisë ishte 10,9% (1,7% më e ulët sesa në vitin paraprak).

Kurse, tek të rinjtë (15-24 vjeç), shkalla e papunësisë ishte 17,3% (4,1% më e ulët sesa në vitin paraprak).

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë

Shkalla e jo-aktivitetit ende vazhdon të mbetet mjaft e lartë (59,3%), mirëpo vërehet një rënie e përqindjes (2,1%), krahasuar me vitin paraprak.

Shkalla e jo-aktivitetit tek femrat ishte shumë e theksuar me 75,8%, krahasuar me meshkujt (42,2%).

Tregtia, ndërtimtaria dhe arsimiti prijnë me punësim

Sektorët ekonomikë që prijnë me punësim vazhdojnë të jenë: tregtia me 20,0%, ndërtimtaria me 11,8%, arsimiti me 9,9%, prodhimi me 9,2%, administrata publike dhe mbrojtja me 8,3%, etj.

Femrat ishin të punësuara kryesisht në sektorët e tregtisë, arsimitit dhe kujdesit shëndetësor me 54,3% të tyre. Ndërsa, meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë, prodhimit, administratës publike dhe mbrojtjes, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimet me 62,4%

Të punësuarit sipas gjinisë dhe aktiviteteve ekonomike 2023, moshë 15+

Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	2.9	1.2	2.4
B - Minierat dhe xehoret	1.1	0.2	0.8
C - Prodhimi	10.1	7.1	9.2
D - Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	2.3	0.7	1.9
E - Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	1.2	0.3	1.0
F - Ndërtimtari	15.9	0.9	11.8
G - Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjeteve dhe motoçikletash	19.9	20.3	20.0
I - Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	7.8	6.3	7.4
H - Transport dhe depozitim	5.5	1.9	4.5
J - Informim dhe komunikim	2.6	2.2	2.5
K - Aktivitete financiare dhe sigurimesh	2.1	2.6	2.3
L - Aktivitete me prona të paluajtshme	0.3	0.2	0.3
M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2.4	3.2	2.6
N - Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3.7	5.7	4.3
O - Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	8.7	7.0	8.3
P - Arsimiti	6.2	19.7	9.9
Q - Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	3.0	14.3	6.1
R - Arti, zbavitja dhe rekreacioni	1.1	1.1	1.1
S - Aktivitete të shërbimeve të tjera	2.3	3.6	2.6
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak	0.1	0.4	0.2
U - Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.9	1.2	1.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Ky publikim ofron të dhëna statistikore për treguesit e tregut të punës bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP). Për realizimin e AFP-së, Vjetore 2023, metodologjia dhe standardet e aplikuara nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostat-it.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), 2023 vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/LaborMarket>